



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. _____ Prot.

Berat, më ___ / ___ /2024

PROCESVERBAL - Tipi i kontrates - PUNE

PER ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PER KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT : "NDERTIMI I SHPATULLAVE TE URES SE LAPARDHASE 2 "

KODI PERKATES NE FJALORIN E PERBASHKET TE PROKURIMIT (CPV) : 45000000-7 Punë ndërtimi,

__VLERA E FONDIT LIMIT : 9 999 988. (nente milion e nenteqindë e nentedhjetë e nente mijë e nenteqind tetedhjetë e tete) leke pa Tvsh **Leke pa T.V.SH .**

Ne baze te nenit 21, pika 2, te Ligjit nr.162/2020 "Per prokurimin publik", nenin 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve per kualifikim per proceduren e sipercituar, me permbajtjen si me poshte :

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3; ;.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Argumentim:kerkesa e mesiperme bazohet ne nenin 77, pika1/a dhe 2, ne LPP. nenin 39 pika 6/p te VKM,nr285, date 12.05..2021, "Per miratimi e rregullave te prokurimit publik ".

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

2.2.1. Operatorët ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 3 vitet e fundit financiare (2021, 2022 - 2023) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentim: kërkesa e mesipërme bazohet në nenin 77, pika 3, në LPP. nenin 43 të VKM, nr.285, date 12.05.2021, "Per miratimi e rregullave te prokurimit publik".

2.2.2. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në zbatimin e punimeve të ndërtimit:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, të jetë në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

1) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:

1. Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me;
2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
3. Situacionin përfundimtar të objektit;

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
2. Situacionin përfundimtar të objektit;
3. Fatura tatimore perfundimtare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e bashkimit të operatorëve ekonomik dhe prokurën e posacme si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruarua në fazën e tenderimit;

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

1.3.2 Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të zoterojë Liçenca Profesionale të lëshuar nga MPPT/MTI ose nga institucionet e autorizuara me ligj si më poshtë:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- NP -1A - Punime germimi ne toke
- NP -4A - Rruge ,autostrada, mbikalime,hekurudha,tramvai,metro,pistaeroportuale.
- NP-5A - Punime nentokesore, ura.e vepra arti.

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

.NS-18 A - Punime topogjeodezike.

- sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licencave profesionale sipas legjislacionit në fuqi;

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës.Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë licencën sipas legjislacionit përkatës përpara zhvillimit të fazës së dytë të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: ”Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga organet kompetente shtetërore.”, si dhe në klasifikimin e niveleve (gërmave) për punimet sipas natyrave respektive, të parashikuara në VKM Nr.42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

| Kategoria e kërkuar | Pershkrimi i kategorisë sipas | Zërat e punimeve që parashikohen të | Niveli i klasifikimit | Vlera e punimeve që parashikohen të |
|---------------------|-------------------------------|-------------------------------------|-----------------------|-------------------------------------|
|---------------------|-------------------------------|-------------------------------------|-----------------------|-------------------------------------|



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

| | legjislacionit të fushës | kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse | kërkuar për kategorinë respektive | kryhen në preventiv, përfshihen në kategorinë përkatëse |
|-----------|--|--|-----------------------------------|--|
| N.P - 1 A | Punime germimi ne toke | Germim themele e plinta b>2m, ekskavator me zinxhir 0.5m3,shkarkimi ne auto | A | Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008, i ndryshuar. |
| N.P - 4 A | Rruge,autostrada, ura mbikalime,hekurudha, tramvai,metro,pistaero portuale | Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri Shtrese stabilizant t=20cm Gabiona me rrjet teli te zinguar e gur kave 1x1x1 m Struktura monolite betoni me çakell C 30/37, për pilota F V hekur betoni periodik Ç-5, Ø >12mm Struktura monolite betoni C20/25, | A | Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008, i ndryshuar. |
| N.P - 5 A | Punime nentokesore, ura.e vepra arti. | Shpim me sonde Ø 0.8 m, ~ 15 m, | A | Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008, i ndryshuar. |
| NS - 18A | Punime topogjeodezike. | Lidhet me piktimin e objektit, kuotat per sitemimin e sheshit etj. | A | Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008, i ndryshuar. |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë drejtues teknik në licencë ose punonjës me kontratë pune me afat vlefshmerie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt te vertetur me, diplomë si më poshtë:

- Inxhinier ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier topograf 1 (një)

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik per secilin pjesetar te stafit teknik duhet te paraqese:

Kontratë pune/, Diplomën Universitare,
(Drejtuesit teknik te jene te siguruar sipas legjislacionit ne fuqi

- **Inxhinieri i ndertimit** eshte pergjegjes per zbatimin e sakte te punimevete objektit qe prokurohet per secilin nga zerat e punimeve ndertimore referuar preventivit.
- **Inxhinieri Topograf Gjeodet** eshte pergjegjes per zbatimin e sakte te kuotave te projektit objekt prokurimi.
- **Argumentimi:***Së pari*, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet disponoje punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

- 1 (një) punonjës që disponon certifikatën si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e e rregullores “Për sigurine në kantier”.

Argumentimi : Kërkesa e shkronjës d) të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht :

Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar *punonjës të kualifikuar* për realizimin e zërave të veçanta të punimeve, të pajisur me dëshmi kualifikimi, minimalisht si më poshtë:

- | | |
|----------------------------|----------|
| • Punonjës teknik ndërtimi | 1 (një) |
| • Saldator | 1 (një) |
| • Karpentier | 3(tre) |
| • Puntor lartësie | 3 (tre) |
| • Hekurthyes | 4(kater) |

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/privatë të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

- **Argumentimi:**Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”. Konkretisht:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

- **Tekniku i ndertimit** eshte i nevojshem per ndjekjen e realizimin te punimeve te ndertimit, sipas zerave te preventivit.
- **Saldatori** eshte i nevojshem per saldimin dhe montimin e pjeseve te parapregatitura beton arme.
- **Karpentieret** jane te nevojshem gjate gjithe periudhes se realizimit te punimeve per punime te ndryshme ne kantier.
- **Punetoret e lartesisë** jane te nevojshem per kalleposjen e kollonave te ures dhe punimet qe do te kryhen kerkojne njerez te trajnuar per punime ne lartesi.
- **Hekurkthyesit** Jane te domozdoshem ne objekt per punimin edhe lidhjen e hekurit gjate gjithe strukturen e ures.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajistur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR., minimalisht si më poshtë :

Manovrator 1 (nje)

Shoferi 2 (dy)

(Në rastet kur mjetet/makineritë disponohen me qera, keta punonjës mund të jenë të kontraktuar).

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratat e punës të vlefshme;
- Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike te kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshinisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtime dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Shenim. Kjo kerkese permbushet nepermjet plotesimit dhe paraqitjes nga operatoret ekonomike te formularit permbledhes te vetedeklarimit, sipas shtojces 8 te DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

2.3.8 Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se **17 (shtatembdhjete) punonjës** për muajin e fundit. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për muajin e fundit
- b) Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.Operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne klasifikim duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës,që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.Vendosja e kriterit për njëpunësim te paktën 17 persona duke përfshire dhe stafin teknik,është në përputhje me volumin e punës, natyrën, ku do të kryhen punimet.

Analizat teknike jane bazuar ne - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve”)..Bazuar ne kater elementet e struktures se koston(material, puntori, makineri, transport) zeri fuqi puntore ze rreth 20% te koston.

Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) per objektin qe prokurohet, si me poshte

ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë (ose ekuivalente)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

ISO 14001:2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor (ose ekuivalente)

ISO 45001:2018 Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë (ose ekuivalente)

Të gjitha çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

***ISO 9001:2015** është ne seri normash dhe standartizimesh nderkombetare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësive, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t'i adoptone për një orientim me të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmerinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogelimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me cmime të ulta.*

***ISO 14001:2015** ofron një kuader praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

ISO 45001-2018 është standard nderkombetare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt

2.3.14 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion të cilat janë si më poshtë vijon:

| Nr | Lloji i makinerive | Pronësia | Njësia | Sasia |
|----|---|------------------------|--------|-------|
| 1 | Kamiona vetshkarkues , kapaciteti mbajtës jo me pak se 18 ton | në pronësi ose me qera | copë | 1 |
| 2 | Kamiona vetshkarkues kapaciteti mbajtes minimalisht 3 -16 ton | në pronësi ose me qera | cope | 1 |
| 3 | Eskavator me zinxhire | në pronësi ose me qera | copë | 1 |
| 4 | Kamion me vinc | në pronësi ose me qera | copë | 1 |
| 5 | Minifadrome me goma Bobcat | në pronësi ose me qera | copë | 1 |
| 6 | Rrul gome-hekur (kapaciteti jo me pak se 6 ton) | në pronësi | copë | 1 |
| 7 | Sond Shpimi | në pronësi ose me qera | | 1 |
| 8 | Komplet i ndihmes se shpejt | Ne pronesi ose me qera | cope | 6 |
| 9 | Kokore | Ne pronesi ose me qera | cope | 17 |
| 10 | Matrapik per thyerje betoni | në pronësi ose me qera | copë | 1 |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

| | | | | |
|----|---------------------------|------------------------|------|---|
| 11 | Vibrator betoni | në pronësi ose me qera | copë | 2 |
| 12 | Prozhektor ndricimi naten | në pronësi ose me qera | copë | 3 |
| 13 | Betoniere 500l | Ne pronesi ose me qera | cope | 2 |
| 14 | Saldatrice | Ne pronesi ose me qera | cope | 1 |
| 15 | Tabela | Ne pronesi ose me qera | cope | 6 |
| 16 | Pompe thithese | Ne pronesi ose me qera | cope | 1 |
| 17 | Autobetoniere | Ne pronesi ose me qera | cope | 1 |

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës *bazuar ne VKM nr. 216, datë 13.04.2023* “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve”).

Mjete dhe paisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”(i ndryshuar) me VKM-në nr.563, datë 03.07.2013 “Për miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndeti për përdorimin e paisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës”, dhe VKM-në nr.564, datë 03.07.2013 “Për miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës” si më poshtë vijon:

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikaten e pronesisë, dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, të shoqerohet me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

- b) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- c) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).*
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

- **Kamiona vetshkarkues** duhen per transportin e dherave ne objekt.
- **Kamiona vetshkarkues** duhen per transportin e materialeve te ndryshme ne zona me te ngushta
- **Eskavator me zinxhire** eshte i nevojshem per sistemimin dhe hapjen e vendit ku do te ndertohet Ura..
- **Kamion me vinc** eshte i nevojshem per transportin dhe shkarkimin e materialeve hekur,cimento ne nje kohe sa me te shkurter.
- **Minifadrome me goma Bobcat** eshte i nevojshem per sistemime te vogla ne zona ku nuk hyjne mjetet e medhaja.
- **Rrul gome-hekur** eshte i nevojshem per ngjeshjen e trasese dhe shpatullave te ures
- Sonda e shpimit.** eshte mjaft e domozdoshme per shpimin e pilotave te ures.
- **Komplet i ndihmes se shpejt** eshte mjaft i nevojshem per tu dhene ndihmen e shpejte punonjesve dhe manovratoreve ne objekt ne rast aksidentesh.
- **Tabelat** jane te nevojshme per sinjalistiken ne objekt.
- Matrapik per thyerje betoni.** eshte i domozdoshem per tyerjen e elementeve beton arme.
- Vibrator betoni** eshte i domozdoshem per vibrimin dhe ngjeshjen e betonit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

-**Betoniere 500l** eshte e domozdoshme per punime betoni ne Objekt sipas zerave te preventivit.

-**Saldatrice** eshte e domozdoshme per saldimin,drejtimin ,bashkimin e detajeve te ndryshem me bashkimin e objekteve te madhesive dhe formave te ndryshme duke perdorue mjetet dhe pajisjes e duhura.

Pompe thithese eshte shume e domozdoshme per thithjen e ujit nga pilotat.

-**Autobetoniere** eshte e domozdoshme per pergatitjen e betonimeve ne objektin qe do te ndertohet.

Argumentimi:Kërkesat e mesiperme jane vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes

| Analize | Emertim Punimesh | Njesi | Sasi | ORE PUNE/p unetori | Ore pune/ma kineri | total ore pune/pu netori | total ore pune/makineri |
|---------|---|-------|------|--------------------|--------------------|--------------------------|-------------------------|
| 2.30 | Germim themele e plinta b>2m, ekskavator me zinxhir 0.5m3,shkarkimi ne auto | m3 | 844 | 0 | 0.034 | 0 | 28.696 |
| An | Shpim me sonda Ø 0.8 m, ~ 15 m, pilota strukture | m | 120 | | 1.13 | 0 | 135.6 |
| 3.244 | Struktura monolite betoni C 20/25 | m3 | 72 | 12.8 | 2.29 | 921.6 | 164.88 |
| 3.248 | Struktura monolite betoni me çakell C 30/37 | m3 | 183 | 12.9 | 2.29 | 2360.7 | 419.07 |
| 3.289 | F V hekur betoni periodik, Ç - 5, Ø > 12mm | ton | 32.3 | 42 | 0.63 | 1356.6 | 20.349 |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

| | | | | | | | |
|---------|---|----|----|-----------------------|-------|--------|--------------------|
| 3.211 | Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri | m2 | 97 | 0.28 | 0.265 | 27.16 | 25.705 |
| 3.212/d | Shtrese stabilizant t=20cm | m2 | 97 | 0.119 | 0.1 | 11.543 | 9.7 |
| 3.331 | Gabiona me rrjet teli te zinguar e gur kave 1x1x1 m | m3 | 50 | 5.6 | 0 | 280 | 0 |
| | | | | | | 4957.6 | 804 |
| | Ore pune gjithsej punetori+makineri | | | | | | 5761.60 |
| | Dite pune gjithsej | | | | | | 720.20 |
| | Grafiku punimeve 2 muaj | | | 1 muaj /22 dite | | | 44 |
| | FUQIA PUNTORE | | | dite pune gjithsej/44 | | | 16.37 |
| | | | | | | | 17 punetore |
| | Inxhinier ndertimi | | | | | | 1 |
| | inxhinier topograf | | | | | | 1 |
| | Teknik ndertimi | | | | | | 1 |
| | saldator | | | | | | 1 |
| | karpentier | | | | | | 3 |
| | punetor lartesis | | | | | | 3 |
| | hekur kthyes | | | | | | 4 |
| | manovrator | | | | | | 1 |
| | shofer | | | | | | 2 |

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike jane hartuar nga specialistet e fushes, bashkengjitur DST ne SPE.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

NJESIA E PROKURIMIT

Specialist I fushes

Jurist

Ekonomist

Rolinda Veliu

Fjoralda Arapi

Ardisa Zhuka

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Ervin DEMO